

ANDREA LLUKANI

**KODIKU I KISHAVE
TË VITHKUQIT**



Tiranë, 2018

ANDREA LLUKANI

**KODIKU I KISHAVE
TË VITHKUQIT**

Tiranë, 2018

Arti grafik: Brunilda Braho

KREU I PARË

KODIKU NR. 1

Gjatë punës për studimin e objekteve që gjenden nëpër standat e Muzeut Historik Kombëtar, na tërhoqën vëmendjen dy kodikë. Kodiku nr. 1 përmban historikun dhe inventarin e kishave të Vithkuqit. Ai fillon nga data 1 janar i vitit 1943. Ka 206 fletë. Kodiku nis me përshkrimin e kishës së Shën e Premtes (faqe 1-11), vijon me përshkrimin e kishës së Shën Mërisë (faqe 11-21), kishën e Shën Gjergjit (faqe 21-30), kishën e Kryeengjëjve Mihail dhe Gavril (faqe 30-41), kishën e Shën Kollit (faqe 41-51), kishën e Shën Kostandinit (faqe 51-61), kishën e Ungjillëzimit (faqe 61-71), kishën e Shën Minait (faqe 71-81), kishën e Shën Pandeleimonit (faqe 81-91) si edhe kishën e Joan Teologut (faqe 101).

Faqe 1

Ky libër regjistrimi është filluar më datë 1 janar të vitit 1943 dhe përmban dyqind e gjashtë fletë, ku janë shënuar njëmbëdhjetë kishat e katundit Vithkuq, qëkur janë ngritur dhe sa herë janë rindërtuar dhe të gjitha sendet që ndodhen në to, si ikona të shenjta, libra të meshës etj. Duke shënuar dhe nga një numër vargor dhe çdo send që është dhuruar, shënohet dhe emri i dhuruesit, data e viti; ashtu, çdo gjë që shton këshilli, regjistrohet në radhën duke shënuar datën, vitin kur blihet. Gjithashtu, në faqen tjetër, që është

faje çregjistrimi, shënohet, kur ndodh ndonjë fatkeqësi që ndonjë kishë rrënohet e digjet dhe ndonjë send prishet ose humbet, data e prishjes ose e humbjes dhe shkaku i humbjes, emri i humbësit në qoftë se humbet ndonjë person nga kujdestarët e kishave.

Përveç këtyre që thamë më sipër, në këtë libër do të shënohen dhe pasuritë kishtare të paluajtshme, si korie, ara e luadhe, vendi ku ndodhen, çfarë sipërfaqe kanë, duke matur me metro dhe me cilët persona kufizohen.

Kjo këshillë, që vendosi këtë regjistrim, mendoi që pasuritë kishtare të jenë të shënuara për të mos u grabitur nga ndokush që mund t'ia thotë zemra ta bëjë këtë punë. Ju lutet këshillave të ardhshme që këtë libër ta ruajnë dhe ta vazhdojnë edhe më në regull për të mirën e kishave dhe nderin e katundit tonë të famshëm, Vithkuq. Vithkuq më 1 janar 1943.

Famullitari i katundit Vithkuq

Si kryetar i këshillit kishtar, Atë Gjergji Deti.

Anëtarët.

Këtu poshtë po shënojmë se qysh më datë 28.08.1943 u sulmua katundi ynë prej ushtrisë italiane dhe dogji gjithë fshatin. Ashtu edhe katër kisha: Shën Kollin, Shën Thanasin, Shën Joanin dhe Shën e Premten. Në këtë kishë ndodheshin gjithë sendet që shënohen në këtë inventar dhe pothuajse u dogjën të gjitha, përveçse disa sendeve më të vlefshme, si një petrahil që është regjistruar me nr. rendor 32 dhe kryqi i madh që është regjistruar me nr. rendor 31, si edhe dy ungjij që janë regjistruar nr. rendor 1, të cilat u ndodhën të mbuluara në një vend të posaçëm dhe mundën të shpëtonin. Këto sende kanë një vlerë të madhe, ndërsa gjithë të tjerat u dogjën.

Faqe 8

Regjistrimi i tokave, luadheve, arave dhe korijsve të kishës së qendrës Shën e Premte

1-Një korijs (pyll) që ndodhet në jugëperëndim të kishës omonime me sipërfaqe prej 910 metra katrorë, që përmban dru ah, dushku e pak borigë dhe kufizohet nga lindja me përroin, nga perëndimi me udhën, nga veriu me përroin dhe nga jugu me Naqo Dhimitër Panaritin dhe përroin.

2-Kjo kishë zotëron dhe një copë pyll (korijs), që ndodhet në lindje të kishës omonime, me sipërfaqe tetëqind e gjashtëdhjetë metër katrorë, që përmban vetëm dru dushku. Ajo kufizohet nga lindja me udhën publike dhe vëllazërinë Koviftoja, nga perëndimi me kopshtin e shkollës dhe nga veriu me bregun e konizmës, plevicën e Loni Kulmit dhe luadhin e kishës. Nga jugu kufizohet me udhën publike.

Këto korijs pylli (tapi) dokumenta gjer sot nuk kanë, vetëm akt njoftjeje, d.m.th, një vendim të gjyqit të paqit që janë herë më anë të pesë dëshmitarëve siç na urdhëronte Kryesia e Kishës me anë të një Qarkoreje Nr. 967, datë 5 maj 1942 dhe numri i akti njoftjes (522) datë 13.06.1942.

3-Një luadh mbas shkollës nga ana e veriut nga dy kile farë i kufizuar nga lindja me përroin dhe bregun e konizmës, nga perëndimi me rrugën. Nga jugu me shkollën dhe sheshin e kishës dhe nga veriu me rrugën publike.

Vithkuq, më 2 janar 1943.

Famullitari i katundit Vithkuq

Si kryetar i këshillit kishtar Atë Gjergji Deti.

Anëtarët.

Faqe 11

Regjistrimi i kishës Shën Mërisë (Zonja e Madhe), që ndodhet në lindje të lagjes Dukas të katundit tonë. Është ndërtuar në vitin (Á × Đ), d.m.th në vitin 1670 se shkronja e fundit nuk njihet, por brenda vitit 1670 e deri në vitin 1680 dhe shkronjat nuk mund të lëçiten se prej kujt është ndërtuar dhe me kujdestarinë e cilit është bërë, mbasi kjo kishë është djegur një pjesë e tempullit brenda dhe është nxirë zografisja dhe djegia është bërë rreth viteve 1909-1910 prej një personi që rrinte në konakët pranë kishës. Emri i personit quheshe Dhori nga katundet e Epirit dhe zjarri i shkaktuar duket nga një qiri që kishte harruar personi i sipërshtënuar ndezur në krahë pranë ikonës së Shën Mërisë. Personi që atë natë që ka shkaktuar zjarrin është zhdukur nga katundi. Në këtë kishë ndodhen këto sende të shenjta.

1-Në ajodhimë (hierore) një ungjill në gjuhën elenishte, shtypur në vitin 1697.

2-Një ungjill në shqip, shtypur në Tiranë, në vitin 1930.

3-Një antimis i shenjtë, shenjtëruar në vitin 1774.

4-Dy libra të meshës në gjuhën shqipe, shtypur në Korçë, në vitin 1929.

5-Një palë rroba të meshës, të vjetra, pa petrahil.

6-Një potir i shenjtë me gjithë veglat e tjera komplet, pa datë.

7-Një temjanicë, një mangall, një mashë, një xhezve për zeon.

8-Në derën e bukur, një muthamen me pikturën e Jesu Krishtit, dhuruar prej Kostandin Thimi Bendor prej këtij katundi, bërë në vitin 1932.

9-Dy shandanë prej tunxhi.

10-Një libër Lutësore, në gjuhën elenisht, shtypur në Veneti, në vitin 1770.

10-Një libër Orollogj, në gjuhën elenisht, shtypur në Veneti, data e shtypjes i mungon.

11-Një libër Apostull, në gjuhën elenisht, shtypur në Athinë, në vitin 1925.

12-Ikona në tempull të shenjtë 6 në anë të djathtë. Ikona e Jesu Krishtit pa datë.

13-Ikona e Shpërfytyrimit (Metamorfozës) Shën Sotirit, pa datë.

14-Ikona e Shën Joan Pagëzorit, pa datë.

15-Ikona e Shën Gjergjit, dëshmorit të madh, pa datë.

16-Në anë të mëngjër, ikona e Shën Mërisë, pa datë.

17-Ikona e një dëshmori, pa emër.

18-Në anë të veriut, ikonë tjetër e Shën Mërisë, pa datë.

19-Gjithnjë në atë anë ikona e Shën Gjergjit, pa datë.

20-Gjithnjë në atë anë të murit, ikona të vogla tetë dhe prej karte gjashtë, pa datë.

21-Një ikonë e vogël prej argjendi e Shën Mërisë, dhuruar prej Preksitheri N. Emekinit (1930).

22-Dy manale (mangalle) prej tunxhi, një poliel prej qelqi dhe i thyer pak.

23-Një ikonë e Jesu Krishtit, në fronin dhespotik, pa datë.

24-Në kishën e grave, dy manale (mangalle) të hekurt, dhjetë ikona të vjetra e të prishura.

25-Në derën e dytë të tempullit, ikona të vogla dhjetë, të zografisura.

26-Në derën e tretë janë gjashtë.....

Deri në këtë datë kjo kishë ka këto sende që shënohen këtu sipër.

Famullitari i katundit Vithkuq

Si kryetar i këshillit kishtar

Atë Gjergji Deti.

Anëtarët.

Faqe 18

Regjistrimi i kishës së Shën Mërisë (Zonja e Madhe).

Këtu poshtë po shënojmë tokat, si korije, ara e luadhe.

1-Një korjie në verilindje të kishës omonime, sipërfaqja prej gjashtëqind e tetëdhjetë (680) metra katrore që përmban vetëm dru dushku dhe kufizohet nga lindja me arat e saj, nga perëndimi me kishën dhe arat e saj, nga veriu me udhën dhe nga jugu me Koli Monin dhe vëllazërinë Kristo Rënxe.

2-Një arë në vendin që quhet Plepi në lindje të kishës omonime, me sipërfaqe $2\frac{1}{2}$ dy e gjysmë killë dhe kufizohet nga lindja me rrugën, nga perëndimi me bregun e kishës dhe korijen, nga jugu me rrugën publike dhe vëllazërinë Metku dhe nga veriu me përroin.

3-Një luadh me emeris arat e gjatën me sipërfaqe dhjetë killë 10 dhe kufizohet nga lindja me përroin dhe nga perëndimi me rrugën publike, nga veriu me rrugën publike dhe nga jugu me përroin.

Vithkuq, më 2 janar 1943.

Famullitari i katundit Vithkuq

Si kryetar i këshillit kishtar Atë Gjergji Deti.

Anëtarët.

Faqe 21

Regjistrimi i kishës së Shën Gjergjit

Kësaj kishe të shenjtë, data e ndërtimit i mungon për shkak se është rrëzuar nga dëbora e madhe që ka rënë në vitin 1895 dhe 1896. Kështu është prishur gjithë zografia. I ka mbetur vetëm në faqen e murit nga ana e lindjes. Kisha është ndërtuar përsëri në vitin 1896, ku është lyer, suva dhe një thollo prej dërrasash dhe e lyer me gëlqere. Ka tempull shumë të bukur me ikona të mira dhe me një ngjyrë floriri shumë të çmuar. Në këtë kishë, që ndodhet në

lindje të lagjes Grekas pranë rrugës publike, ndodhen këto sende të shenjta të luajtëshme.

1-Në ajodhimë (hierore) një ungjill në gjuhën elenishte, shtypur në Janinë, në vitin 1719.

2-Një antimis i shenjtë, i vjetër por i përkryer, vetëm me një kryq të shenjtë, dhuruar në vitin 1768.

3-Dy shandanë të tunxhtë, një temjanicë, dy shtroja në altarin e shenjtë, njëra prej pambuku, dhuruar prej Gaqo Sotirit dhe tjetra prej mëndafshi, dhuruar prej Sotir Pano Tolës.

5-Në proskomidhi, dy ikona të vogla, një me Jesu Krishtin dhe tjetra me Shën Mërinë, Shën Gjergjin dhe Shën Mitrit. Në tempull ka 10 ikona në anën e djathtë.

6-Një ikonë e Jesu Krishtit, e Shën Joan Pagëzorit, pa datë.

7-Ikonë e Shën Mitrit pa datë, e Shën Thanasit e vjetër dhe pak e prishur.

8-Ikona të tre hierarkëve, Shën Vasilit, Shën Grigorit dhe Shën Joan Gojartit, bërë me ndihmën e bakenjve të Korçës, më 27 mars të vitit 1767.

9-Në anë të mëngjër, ikona e Shën Mërisë dhe e Shën Gjergjit, të dyja pa datë.

10-Ikona e kryeengjellit Mihail, e Shën Kollit, pa datë.

11-Ikona e Shën Joan Pagëzorit dhe një ikonë e Shën Mërisë, e vjetër. Ka një shkrim që shënon se është konizmë e kishës së madhe të shpërfytyrimit, që ka qenë pranë katundit Nikolicë dhe është bërë në vitin 1595.

12-Një ikonë e Jesu Krishtit në fron të dhespotit, pa datë.

13-Një ikonë e Shën Joan Theologut. Në fundin e saj janë këta shenjtorë: Shën Pjetri e Shën Pavli dhe dy etërit e mëdhenj.....dhe një ikonë e vogël që mban fytyrën e lindjes së Jesu Krishtit.

Regjistrimi i kishës së kryeengjëjve Mihail e Gavril

Kjo kishë është në veriperëndim të lagjes Grekas dhe ka këto shkronja në gjuhën eleniste, që shënojnë vitin e ndërtimit: ΑίϰαΥñεç Υέ αÙεñùí αΠò ΥΒ Υóíτò α÷ðâ εάβ ÛíεóοίñΠεç ü εάβíò εάβ ðÛíóáððòíò íγòíò ò þí ðáííááβóòùí ðáíεάñ÷þí Ìε÷άΠε εάβ ΆάάñεΠε, æÛ Υúü äíò ò þí áγðñáεΥíóúí ÷ñεóòεάíþí ðð ðíεέçáβò ðáγóçò εάβ æÛ óóíáññíΠò êüðíò ê(αβ) ìü÷εíò Óðáyñíò βáñΥúò εάβ íβêííüííò ê(αβ) Υðεóñüðíò Ûñ÷εáñáðáyííòíò ðíγ ÐáíεάñùòÛòíò Ìçòñíðíεβòíò Êάóòí(ñ)β(άò) Êòñβíò Êòñβíò ×ñòóÛíεíò βáñáðáyííòíò ò þí áγέάááóóÛòúí βáñΥúí ΥΒ Υóíτò áøεç (=1728) Ìêòùáñβíò Û Shpjegimi në gjuhën shqipe të shkrimit që shënohet më lart është: “U ndërtua prej themeli në vitin 1682 dhe u pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i taksiarkëve të mëdhenj, Mihael e Gabriel, me shpenzimet e të krishterëve që gjenden në këtë qytet dhe me kontributin, përpjekjet dhe mundimet e prift Stavrit, ekonom dhe epitrop, në kohën e peshkopatit të gjithëhirshmit mitropolitit të Kosturit, zotit Krisanth, në kohën kur ishin famullitarë priftërinjtë e shumëdevotshëm, në vitin 1728, tetor 1”. Këtu poshtë do të shënojmë gjithë sendet e shenjta që ndodhen në këtë kishë si ikona, libra të tjerë dhe kush nga këto ka dhe datë kur është bërë.

- 1-Në altar të shenjtë, një ungjill në gjuhë elenisht, pa datë.
- 2-Një antimis i shenjtë, i shenjtëruar prej arkimandritit Simeon të varrit të shenjtë në vitin 1751.
- 3-Një libër i meshës në gjuhën elenisht, shtypur në Athinë, në vitin 1924.
- 4-Një libër i meshës në gjuhën shqip, shtypur në Korçë, në vitin 1930.

5-Dy shandanë prej tunxhi, dy shtrosa, një prej pambuku, dhuruar prej Gaqo Sotirit dhe tjetra prej mëndafshi artificial, dhuruar prej Sotir Pano Tolës.

6-Një palë kungishte me gjithë mbulesat, potiri i shenjtë, dhuruar prej familjes Konstandini në vitin 1919.

7-Një temjanicë e vjetër, një palë rroba të meshës të vjetra, një mangall.

8-Një kaci hekuri, një mashë, dy disqe, punuar dhe dhuruar prej Nuçi Koli Kitës në vitin 1938.

9-Një ikonë e Shën Mërisë që ndodhet në proskomidhi.

10-Në tempull, ikona të mëdha 10 në të djathtë Jesu Krishti e Shën Joan Pagëzori, e Shën Kollit, e Shën Gjergjit, e Shën Thanasit pa datë.

12-Në anë të mëngjër, ikonat e Shën Mërisë e Shën Mihailit, Shën Anargjendërt Kozma dhe Dhamiano, e Shën Mitrit, e Shën e Premtes, të gjitha pa datë.

13-Në sërën e dytë, ikona të vogla me fytyra të ndryshme.

14-Në sërën e tretë, ikona të vogla të pikturuara në dërrasë të madhe. Jesu Krishti, Shën Mëria, Joan Pagëzori dhe 12 apostujve dhe të profetëve.

15-Një kryq i madh mbi tempullin më një anë dhe më anën tjetër, Joan Theollogu.

16-Në proskinitar në anë të djathtë një ikonë me Jesu Krishtin dhe me kryeengjëjt e gjithë shenjtorët, të bëra për kujtim të Kristo Dukës, epitropit në vitin 1778.

17-Dy ikona të vogla, njëra me Jesu Krishtin mes popullit të hypur në gomar, duke vajtur në Jerusalem, ku qe pritur me nderim të madh dhe tjetra Jesu Krishti, e Diela e Shën Thomait, që ka vënë dorën në brinjë kur e pa të ngjallur prej së vdekurësh.

18-Në proskinitar më të mëngjër, një ikonë mbledhja e të patrupëve, d.m.th e kryeengjësve Mihail e Gavril dhe të fuqive të tyre ëngjëllore dhe me Jesu Krishtin në mes, bërë në vitin (1874).

19-Dy ikona në një dërrasë, një e Shën Trinisë dhe një me Shën Marinë me Jesu Krishtin në kraharor, këto pa datë.

20-Më të djathtë të proskinitarit, një dërrasë me një kryq në mest dhe me Krishtin të kryqëzuar dhe në një cep, kryeengjëlli Mihail dhe në tjetrin cep dëshmorët e mëdhenj Shën Gjergji dhe Shën Mitri. Në cepat e poshtëm në një anë, Shën Joan Theollogu dhe në anën tjetër, Shën Mëria dhe poshtë, Shën Kolli e Shën e Premtja.

21-Dy mangallë prej tunxhi dhe dy prej hekuri për qirinj.

22-Dy poliele prej tunxhi, një Lutjesor në gjuhën elenisht pa datë.

23-Një Apostull në gjuhën shqip, shtypur në Firence, në vitin 1931.

24-Një libër i meshës në gjuhën shqip, shtypur në Korçë, në vitin 1930.

25-Një Tipiko në gjuhën elenisht, shtypur në Veneti, në vitin 1884.

Deri në këtë datë kjo kishë ka këto sende të luajtshme që shënohen më lart.

Vithkuq, më 3 janar 1943.

Famullitari i katundit Vithkuq

Si kryetar i këshillit kishtar Atë Gjergji Deti.

Anëtarët.

Faqe 37

Këtu poshtë po shënojmë tokat e kësaj kisha, si korije, ara e luadhe.

1-Kjo kishë zotëron një korije (pyll) që ndodhet në verilindje të kishës omonime, me sipërfaqe prej 1170 metra katrore, që përmban vetëm dru dushku dhe kufizohet nga lindja me përroin dhe Milto Kitën, ndërsa nga jugu me udhën publike.

2-Kjo kishë zotëron edhe një luadh, që ndodhet në vendin që quhet Guret e Kishës në jug të kishës omonime dhe është në sipërfaqe nga dy killë farë dhe kufizohet nga lindja me rrugën publike, nga perëndimi me gurët e fushës dhe vëllezërinë Lloshore, nga veriu me sheshin e pleqve dhe nga jugu me rrugën publike.

Vithkuq, më 3 janar 1943.

Famullitari i katundit Vithkuq

Si kryetar i këshillit kishtar Atë Gjergji Deti.

Anëtarët.

Faqe 41

Regjistrimi i manastirit të Shën Kollit

Te ky manastir shkrimet janë fshirë edhe nuk mund të lëqiten. Viti, që është ndërtuar, ka këto shkronja (î Ñî Á). Sendet e shenjta që ndodhen në këtë manastir janë në ajodhimë.

1-Në alltar të shenjtë, një ungjill në gjuhën elenisht, shtypur në vitin 1768.

2-Një andimis i shenjtë, i shenjtëruar në vitin 1733.

3-Një shtrojë plaçë e kuqe, dy shandanë prej tunxhi, një mbulesë për ungjillin.

4-Në proskomidhi, një potir i shenjtë, i bërë në vitin 1766 për kujtim të shërbëtorit të Perëndisë Kristofor, themelonjësit të manastirit.

5-Një dhiskar me gjithë veglat e tjera e mbulesat e një palë rroba të vjetra të meshës.

6-Një lipsan i shenjtë i jeroleshmorit Theodor ku shkruhet rreth kuisë se: Ky lipsan është i manastirit Shën Kollë dhe mban vitin 1800.

7-Një kryq prej dhoge (dërrase) i mermë, me fytyrën e Jesu Krishtit.

- 8-Një ikonë e varur në të djathtë të altarit të shenjtë, në krye ka fytyrën e Shën Triadhës dhe shumë shenjtorë të tjerë, pa datë.
- 9-Një shtrojë e jeshiltë në paravënie dhe një epitaf prej karte, ngjitur në mur. Një shandan prej teneqeje, dy dhisqe për naforën, një sënduk i vjetër.
- 10-Në tempull janë ikona të mëdha; në anë të djathtë ikona e Jesu Krishtit bërë me dorën e zogرافit Kostandinit nga Korça, në vitin 1774.
- 11-Ikona e Joan Pagëzorit, bërë më 27 mars të vitit 1774.
- 12-Ikona e Shën Kollit, bërë prej jeromonak Prokopit, në vitin 1788.
- 13-Në anën e mëngjër, ikona e Shën Mërisë, bërë prej dorës së zogرافit Kostandin nga Korça, në vitin 1774.
- 14-Ikona e Shën Mitrit, bërë në vitin 1774.
- 15-Mbas murit më të mëngjër, ikona e Shën Gjergjit, pa datë.
- 16-Ikona e anargjendëve Kozma e Dhamjan, pa datë.
- 17-Një ikonë me Jesu Krishtin në mes në fron dhe Joan Pagëzorin në të djathtë e Shën Mëria në të mëngjër. Në mes të ikonës, Shën Spiridhoni, Shën Harallambi, Shën Thanasi e Shën Kolli e në fund të ikonës, dëshmorët e mëdhënj, Shën Gjergji e Shën Mitri.
- 18-Një ikonë e vogël e Shën Mitrit, pa datë.
- 19-Në anën e djathtë pas murit nga jugu, një ikonë e Shën Kollit, pa datë.
- 20-Në derë të bukur, një ikonë e Shën Kollit prej mushamaje.
- 21-Në derë të veriut, një ikonë e Shën Mërisë, pa datë.
- 22-Në derën e dytë, një ikonë e Jesu Krishtit, në mest, Shën Joan Pagëzori e Shën Mëria, të dy kryeengjëjt dhe dymbëdhjetë apostujt, pa datë.

23-Në derën e tretë, kryqi i madh në mest, edhe dhjetë ikona të vogla pa datë.

24-Në fron të dhespotit, një ikonë e Shpërfytyrimit të Shpëtimtarit.

26-Pas murit nga ana e veriut, një ikonë e vjetër me lloj shumë fytyrash shenjtorësh. Dy mangallë të hekurt, një poliele prej tunxhi. Vërtetohet se në kishën e lartpërmendur ndodheshin sendet e shënuara më lart deri në këtë datë.

Vithkuq, më 4 janar 1943.

Famullitari i katundit Vithkuq

Si kryetar i këshillit kishtar Atë Gjergji Deti.

Anëtarët.

Faqe 41

Çregjistrimi i manastirit të Shën Kollit

Këtu poshtë po shkruajmë çregjistrimin e manastirit Shën Koll, i cili që më datën 28.08.1943 u dogj prej ushtarëve italianë, që sulmuan katundin tonë. Pas shkurtit, që siç dihet ,në gjithë botën që njerëzia plasën nga shtypjet e sundesve të partisë fashiste e naziste dhe bënë lidhje dhe formuan partinë nacionale çlirimtare, pra edhe katundi ynë i famshëm nuk ndenji neutral se dëshëronte çlirimin dhe u bë qendra më e madhe për këtë punë; prandaj dhe cmira e njerëzimit e dogji krejt katundin dhe katër kisha: Shën Kollin, Shën Thanasin, Shën e Premten dhe Shën Joanin. Këtu me kishat e treguan më hapur ligësinë e tyre, siç janë fashistët italianë dhe tradhëtarët e vendit tonë, që i ushqenin këta trima të çquar të botës.

Nga ky manastir i vogël nuk shpëtoi asgjë, u dogj i gjithë, si kisha, ashtu edhe disa dhoma që ndodheshin aty pranë kishës.

Regjistrimi i kishës së profetit Ilia

Kjo kishë e shenjtë ndodhet në jugperëndim të lagjes Saraq, mbi një breg të pyllëzuar e të stolisur me bukuri natyrale. Kësaj kishë nuk i dihet data dhe koha kur është ngritur për arsye se në kishat e malit nuk kanë bërë zografi dhe nuk kemi gjetur ndonjë shkresë që të shkruante mbi datimin e saj. Nëse kanë pasur të tilla shkresa priftërinjtë e katundit tonë, ato janë zhdukur. Siç kuptohet, lipset të jetë mjaft e vjetër. Kjo vërtetohet nga korija që ka rrotull saj, mbasi në këtë korije ndodhen shumë drurë të vjetër e ata janë mbrojtur që në kohën që është ngritur kisha. Kjo kishë u dogj aksidentalisht në vitin 1937, në muajin nëntor dhe u rindërtua në vitin 1938, në muajin korrik dhe u meshua në ditën e festës më 20 të këtij muaji. Ishte bërë shumë e madhe se çka qenë. Kujdestarë të kishës qenë z.z. Tushi V. Koleci, Loni V. Kulmi, Isak V. Riska e Miti K. Rënxa, të cilët treguan kujdes në më të madh për rindërtimin e kësaj kishë, që është në atë vend aqë të bukur. Në këtë kishë ndodhen këto pak sende.

1-Kora të shënjtja, në anë të djathtë, një ikonë e Jesu Krishtit, e blerë në vitin 1921 dhe e dhuruar prej Rako e Lipe Mial Tili.

2-Një korë e Shën Joan Pagëzorit, blerë në vitin 1938, dhuruar prej Ilo e Luxi Spiro Gjilos.

3-Një korë e Shën Profitit Ilia, blerë prej jeromonakut Atë Kozma.

4-Një korë e Shën Mëhillit, dhuruar prej Mihail Ligor Stratit.

5-Në anë të mëngjër, një korë e Shën Mërisë, e vjetër.

6-Një korë e Shën Gjergjit dhe të vogla dy, njëra e Shën Vasilit, dhuruar prej Vasil Guri Rrapos dhe një e Shën Profitit Ilia e vjetër.

Për sa shkruam më lart, vërtetohet se sot ndodhen në kishë.

Vithkuq, më 5 janar 1943.

Famullitari i katundit Vithkuq
Si kryetar i këshillit kishtar Atë Gjergji Deti.
Anëtarët.

Faqe 61

Regjistrimi i kishës së Shën Kostandinit

Kjo kishë ndodhet në veri të lagjes Grekas, mbi një breg të Llurit. Ishte ngritur në kohët kur ka qenë lagjja Tataç dhe siç e rrëfejnë edhe shenjat e varreve të vjetra, këtë kishë e kanë patur për varrime mbi kishën e Shën Vangjelizmoit, që ndodhet në veriperëndim të lagjes Tataç. Nuk ka vend për varreza dhe mund të jetë ngritur dhe më pas se që të dyjave u mungon data e ngritjes në këtë kishë të vogël, por piktoreske. Sot ndodhet pjesa e kishës së burrave, me zografi të pikturave të shenjtorëve vetëm pak pjesë janë prishur dhe pjesa e kishës së grave është në gjendje të shëndoshë. Në këtë kishë ndodhen këto sende të shenjta.

1-Në jerore, në proskomidhi, konizma me fytyrën e Shën Gjergjit, pa datë.

2-Në tempull, në anë të djathtë, ikona e Jesu Krishtit, pa datë.

3-Pas saj, ikona e Shën Kollit.

4-Më tej, ikona e Shën Kostandinit dhe Shën Elenës.

5-Në anë të mëngjër, ikona e Shën Mërisë.

Vërtetohet se deri në këtë datë sendet e lartshënuara ndodhen.

Vithkuq, më 7 janar 1943.

Famullitari i katundit Vithkuq
Si kryetar i këshillit kishtar Atë Gjergji Deti.
Anëtarët.

Faqe 81

Regjistrimi i kishës së Shën Minait

Kjo kishë ndodhet në veriperëndim të lagjes Grekas dhe në mes të lagjes së vjetër të Vithkuqit të parë, Lias. Kjo kishë është mjaft e vjetër, siç duket, por data e ndërtimit i mungon. Mund ta ketë pasur, por duket se është prishur, mbasi mbi shumë vite është zografisur. Kisha e burrave është e zografisur me piktura të shumta shenjtorësh, ashtu dhe anë e murit nga lindja në kishën e grave është e zografisur. Në këtë kishë ndodhen këto sende të shenjta, që poshtë shënohen.

1-Në templon, në anë të djathtë, ikona e Jesu Krishtit, pa datë.

2-Në templon, në anë të djathtë, ikona e Joan Pagezorit, pa datë.

3-Në templon, në anën e djathtë, ikona e Kryeengjellit Mihail, pa datë.

4-Në anë të mëngjër, ikona e Shën Mërisë, pa datë.

5-Në anë të mëngjër, ikona e Shën Minait.

Në derën e dytë, mbi ikonat e mëdha janë në mest ikona e Jesu Krishtit, e Shën Joan Pagëzorit dhe e Shën Marisë dhe 12 apostujve. Mbi to është kryqi më fytyrën e Jesu Krishtit të mbërthyer.

Vërtetohet se deri në këtë datë sendet e naltshënuara ndodhen.

Vithkuq, më 7 janar 1943.

Famullitari i katundit Vithkuq

Si kryetar i këshillit kishtar Atë Gjergji Deti.

Anëtarët.

Faqe 82

Regjistrimi i kishës së Shën Pandelejmonit

Kjo kishë ndodhet në perëndim të lagjes Grekas, në mal, pranë vendit që quhet Guri i Lules, në një breg shkëmbi dhe është ngritur prej kohëve të para, por ndonjë datë nuk dimë me saktësi, por merret vesh se ishte mjaft e vjetër. Këtë e tregon një copë tjegull. Kanë qënë aty rreth kishës që është mbrojtur natyrisht që kur është ngritur. Kështu, mbasi njerëzit e moçëm atje ku ndërtonin ndonjë kishë, nuk i prisnin drurët, por i ruanin për bukurinë e nderin e kishës. Në këtë kishë ndodhen ikona të shënjta e në tempull, në anë të djathtë ikona e Jesu Krishtit, pa datë. Ikona e Shën Pandelejmonit e vogël. Në anë të mëngjër, një ikonë e Shën Marisë. Vërtetohet se deri në këtë datë sendet e naltshënuara ndodhen. Vithkuq, më 7 janar 1943.

Famullitari i katundit Vithkuq

Si kryetar i këshillit kishtar Atë Gjergji Deti.

Anëtarët.

Faqe 101

Regjistrimi i kishës së Shën Joan Theologut

Kjo kishë ka qënë e vjetër, që në kohën e sundimit të Turqisë dhe prapë është rindërtuar...Kështu disa ikona të shenjta që kishin qënë më parë në të i shpunë në kishën e Shën Gjergjit, që është pranë saj. Kjo kishë ndodhet në lindje të lagjes Grekas Vithkuq, më 7 janar 1943.

Famullitari i katundit Vithkuq

Si kryetar i këshillit kishtar Atë Gjergji Deti.

Anëtarët.

KODIKU NR. 2

Kodiku nr. 2 përmban: panairin e Shën Pjetrit, në Vithkuq, regjistrimin e kishës së manastirit, regjistrimin e librave të shenjtë, regjistrimin e librave të bibliotekës, regjistrimin e ndërtesave të manastirit, regjistrimin e sendeve, regjistrimin e tokave të manastirit, regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, si edhe regjistrimin e kishës së Shën Thanasit.

Faqe 1

Panairi i manastirit historik Shën Pjetër, Vithkuq

Bëhet e ditur të nderçmit publik që të hënën që vjen, 29 Qershor, këtë vit kremtohet panairi i përvitshëm dhe i zakonshëm i Manastirit të famëshme Shën Pjetër, dymbëdhjetë apostojtë.

Imzot Agathangjeli, Episkop i Beratit, Vlorës dhe Kaninës do të kryesojë meshën manastiriale. Janë, pra të lutur gjithë besnikët të vizitojnë këtë manastir piktoresk.

Korçë, më 25 Qershor 1936.

Nga manastiri i Shën Pjetrit.

Faqe 1

Regjistrimi i kishës së manastirit të Shën Pjetrit

Këtu poshtë po shënojmë sendet e shenjta që ndodhen në kishë, si libra e ikona të shenjta e të tjera.

1-Një ungjill në gjuhën elenishte, shtypur në vitin 1760.

2-Një ungjill në gjuhën shqip, shtypur në Tiranë në vitin 1930.

3-Një antimis i shenjtë, i shenjtëruar prej patrikut igumenik të Stambollit, z.z Meletios, në vitin 1845, në muajin gusht.

4-Një epitaf i bërë më 21 mars të vitit 1737.

5-Një epitaf i ri, i bërë dhuratë prej igumenit të manastirit të këtyre kohëve, jeromonakut Atë Kozma Krëshova, në vitin 1936.

6-Një shtroje prej pambuku me lule.

7-Një shtroje prej mëndafshi artificial, dhuruar prej Sotir Tolës.

8-Një libër meshe në gjuhën elinisht, shtypur në Patrikanë më dhjetor, 1884.

9-Dy libra të meshës në gjuhën shqipe, shtypur në Korçë në vitin 1930.

10-Dy kryqe, një prej argjendi e tjetri prej

11-Një kuti prej druri (artofor), d.m.th, kungimmbajtëse.

12-Një kryq i Jesu Krishtit i vogël, në një anë Joan Pagëzori dhe në anë tjetër Shën Mëria.

13-Kundrejt altarit një gur prej mermeri, i gdhendur bukur.....

14-Dy kandila, njëra prej argjendi dhuruar prej Koli Mitros nga Panariti dhe një tunxhi. Një palë rroba të meshës të vjetra.

15-Në proskomidhi, njëme gjithë yll dhe lugën e kungimit, shtizën e shenjtë të argjendtë.

16-Dy temjanica njera prej argjendi e tjetra prej tunxhi.

17-Një xhevze për zeon (ujin e nxehtë), një ikonë Burimi Jetëdhënës, pa datë.

- 18-Një ikonë, e Diela e Shën Thomait, bërë në vitin 1773.
- 19-Një ikonë e Vangjelizmoit, pa datë, një korë e Papandisë, bërë në vitin 1773.
- 20-Një korë e Shën Lazrit, bërë në vitin 1618.
- 21-Një korë me Jesu Krishtin, një me Shën Pjetrin dhe një me Shën Pavlin.
- 22-Një.... pambuku, një e vogël...dytë vjetër. Një dollap, dy sënduqe, një temjanicë e madhe e papërdorur. Një kandil prej qelqi, një...me fytyrat e të 12 apostujve. Katër copë konizma, dy me xham, një korë e vogël e kryqëzimit. Një korë prej karte me fytyrën e Shën Mërisë.
- Faqe 2.
- 23-Kora në të djathtë, korë e Jesu Krishtit, bërë në vitin 1762.
- 24-Kora e Shën Joan Pagëzorit, bërë në vitin 1762.
- 25-Kora e kryeengjëljeve, bërë në vitin 1762.
- 26-Kora e Shën Mërisë Burimi Jetëdhënës, bërë në vitin 1762.
- 27-Në anën e mëngjër, kora e Shën Mërisë, bërë në vitin 1762.
- 28-Kora e dymbëdhjetë apostujve, bërë në vitin 1762.
- 29-Kora e tre kryepiftërinjve Shën Kollit, Shën Spiridhoni dhe Shën Harallambi, bërë në vitin 1762.
- 30-Kora e Shën Trinisë me gjithë shenjtorët, bërë në vitin 1762.
- 31-Në sërën e dytë: 1) Kryqëzimi i Krishtit. 2) Zbritja në ferr. 3) E diela e dafinave. 4) Hyrja e Shën Mërisë në kishë (21 nëntor). 5) Tre hierarkët. 6) Jesu Krishti në fron. 7) Lindja e Shën Marisë. 8) Pesëdhjetore (Pendikosti). 9) Shpërfytyrimi (6 gusht). 10) Sheshja (Analipsi). 11) Darka mistike (E enjte e madhe). 12) Shën Lazëri. 13) Pagëzimi i Jesu Krishtit. 14) Shën Trifoni. 15) Shën Vangjelizmoi. 16) Lindja e Krishtit. 17) Hyrja e Shën Mërisë në kishë. 18) Rrethprerja e Jesu Krishtit (Peritomi).

37-Në sërën e tretë. Kryqi ...me një apostull, Joan Teologu dhe në anën tjetër, Shën Maria.

38-Në proskinitar, një korë e Shën Mërisë dhe në fund, pikturuar Jesu Krishti dhe rreth korës dymbëdhjetë profetër.

39-Një korë e vogël e Shën Mërisë prej.... brenda dhe sipër prej argjendi.

40-Një korë e dy kryeapostujve, Shën Pjetër dhe Pavël, bërë në vitin 1755.

41-Proskinitari prej druri arre, punuar mirë, i skalitur me shumë lule e në majë me një shkabonjë dykrenore, mbi kryet e saj një kryq të lyer me bojë krisafi.

42-Proskinitari në anë të mëngjër, i skalitur mirë dhe i lyer me bojë krisafi. Në të, një kryq, një korë e Shën Pjetrit përbrenda prej karte dhe sipër teneqe e mirë dhe xham mbi të, dhuruar prej Fani dhe Minella Noçkës (1933).

43-Kandil prej argjendi...prej qelqi, kandili i kryqit prej argjendi katër copë.....

44-Tri poliele tunxhi, një e madhe e dy të vogla. Froni dhespotik prej dru arre, i skalitur mirë, me kube. Një korë e Jesu Krishtit e varur ,me rrobat e meshës e ndenjor në fron, bërë në vitin 1710.

45-Në proskinitar kundrejt fronit dhespotik, kora e Fjetjes së Shën Mërisë, bërë prej dorës së zogرافit Vasil Frataniti për kujtim dhe ndjesë të Dhespinë e Mari Fugës në vitin 1919. Gjithë fytyrat e korës kanë kurorë prej argjendi.

46-Një korë e vogël e Shpërfytyrimit të Shpëtimtarit, pa datë.

47-Një korë, Ngjallja e Jesu Krishtit, dhuruar prej Stavre Fonit, bërë në vitin 1924.

48-Një korë prej karte e Shën Mërisë me xham, bërë në Malin e Shenjtë Athos prej Nifon M. Kafsokalivit.

- 49-Në anën e djathtë, pas murit, një korë e vjetër fort, që përmban një fytyrë të një kryepriifti që pjesën e surratit e ka të prishur.
- 50-Një korë e Shën Mërisë dhe rrotull korës, 12 profitër dhe 12 apostujt, e çarë në mes e në fund...shtatë skena.
- 51-Një korë e vogël e vjetër shumë e Shën Kollit, një korë e Shën Spiridhonit, e vogël dhe e vjetër shumë, e çarë përmes.
- 52-Një kryq prej druri të vjetër me Jesu Krishtin në mest dhe anëve, Shën Joan Pagëzorin dhe Shën Mërinë në anën tjetër.
- 53-Në anë të mëngjër pas murit, një korë Rrethprerja e Jesu Krishtit dhe në fund të kësaj kore fytyra e Shën Vasilit.
- 54-Një korë e Jesu Krishtit, ndenjuri mbi pulisht gomareje (e diela e dafinës).
- 55-Një korë e Shën Marisë, e vogël në formë që mbyllet dhe në anën tjetër ka fytyra shenjtorësh, profetin Ilia dhe disa të tjerë.
- 56-Në kolonën e fundit, në anë të mëngjër, një korë e kryeengjellit Shën Mihail që mban në dorë peshën e drejtësisë. Një korë e vogël e vjetër e Shën Kollit.
- 57-Në penxheren që është nga kisha e grave, dy kora, njëra me dymbëdhjetë apostujt dhe tjetra e Shën Joan Pagëzorit, e vjetër e pa datë.
- 58-Tre kandila prej tunxhi e dy prej hekuri, të vegjël.
- 59-Në pjesën e kishës së grave, mbas murit nga ana e lindjes, varur në të djathtë, një korë me mbërthimin në kryq të Jesu Krishtit, bërë në vitin 1818.
- 60-Një korë e Ngritjes së profetit Ilia në qiell, pa datë.
- 61-Në anë të mëngjër, një korë me Lindjen e Jesu Krishtit. Magët që po vijnë me dhurata. Një korë me Ipapandinë.
- 62-Një korë me Rushajet dhe një me kryqëzimin e Jesu Krishtit dhe me një anë, Joan Theologun dhe në anë tjetër, Shën Mërinë.

Faqe 4

Regjistrimi i librave të shenjtë të kishës së manastirit

Këtu poshtë po shënojmë librat që përmbajnë shërbesat e shenjta. Cilado libër që përmban dhe ku është shtypur edhe në çë vit, në qoftë se ka fletën e sipërme që shënon vitin.

1-Një Lutësore (Paraklitiki), në gjuhë elenisht, shtypur në Veneti, në vitin 1869.

2-Dy Triodhë që përmbajnë këndimet e kreshmëve, datat u mungojnë.

3-Një Pesëdhjetore (Pendikostar) në gjuhën elenisht, që përmban këndimet e Ngjalljes së Krishtit dhe deri në Rushajet shtypur në Veneti, në vitin 1873.

4-Një mujore e dhjetorit në gjuhën elenisht, shtypur në Athinë, në vitin 1896.

5- Një mujore e janarit në gjuhën elenisht, shtypur në Athinë, në vitin 1896.

6-Një mujore e shkurtit në gjuhën elenisht, shtypur në Athinë, në vitin 1896.

7-Një mujore e marsit në gjuhën elenisht, shtypur në Athinë, në vitin 1896.

8-Një mujore e prillit në gjuhën elenisht, shtypur në Athinë, në vitin 1896.

9-Një mujore e majit në gjuhën elenisht, shtypur në Athinë, në vitin 1896.

10-Një mujore e qershorit në gjuhën elenisht, shtypur në Athinë, në vitin 1896.

11-Një mujore e korrikut në gjuhën elenisht, shtypur në Athinë, në vitin 1896.

12-Një mujore e gushtit në gjuhën elenisht, shtypur në Athinë, në vitin 1896.

13-Një mujore e dhjetorit, shtypur në Veneti, në vitin 1732.

14-Një mujore e oktomvrit, shtypur në Veneti, në vitin 1684.

15-Një mujore e noemvrit, shtypur në Veneti, në vitin 1659.

16-Një mujore e qershorit, shtypur në Veneti, në vitin 1770.

17-Një mujore e majit, shtypur në Veneti, në vitin 1755.

18-Një mujore e gushtit, shtypur në Veneti, në vitin 1798.

19-Një mujore e prillit, shtypur në Veneti, në vitin 1777.

20-Një mujore e oktomvrit, shtypur në Veneti, në vitin 1754.

21-Një mujore e septemvrit, shtypur në Veneti, në vitin 1754.

22-Një mujore e gushtit, shtypur në Veneti, në vitin 1636.

24-Një libër Orollogji, dhuruar prej Sotir Mborjes, data i mungon.

25-Një Apostull në gjuhën shqip, shtypur në Tiranë, në vitin 1931.

26-Një mujore e muajit Nëntor, shtypur në Veneti, në vitin 1735.

27-Një Sinaksaristis që përmban jetët e shenjtoreëve të gjithë vitit, shtypur në Veneti, në vitin 1819.

28-Një libër, Ungjilli i vjetër, data i mungon.

Faqe 5

29-Një mujore e muajit prill, shtypur në Veneti, në vitin 1761.

30-Një Pesëdhjetore (Pendikostar) e vjetër, data i mungon.

31-Një mujore e septemvrit, shtypur në Veneti, në vitin 1678.

32-Një mujore e shkurtit, shtypur në Veneti, në vitin 1689.

33-Një mujore e oktomvrit, i vjetër, data i mungon.

34-Një libër Triodhi, i vjetër, data i mungon.

35-Një mujore e shkurtit, shtypur në Veneti, në vitin 1732.

36-Një mujore e nëntorit, shtypur në Veneti, në vitin 1778.

37-Një mujore e oktovrit, shtypur në Veneti, në vitin 1689.

38-Një mujore e majit, shtypur në Veneti, në vitin 1678.

- 39-Një libër Tipiko i vjetër, pa datë.
- 40-Një libër i vjetër pa datë.
- 41-Një mujore e janarit pa datë.
- 42-Një mujore e gushtit, shtypur në Veneti, në vitin 1772.
- 43-Një libër Triodhi, i vjetër pa datë.
- 44-Një mujore e marsit, shtypur në Veneti, në vitin 1722.
- 45-Një mujore e janarit, shtypur në Veneti, në vitin 1684.
- 46-Një mujore e marsit, shtypur në Veneti, në vitin 1675.
- 47-Një libër Tipikojë (Rregullatore), shtypur në Veneti, në vitin 1685.

Faqe 5

Regjistrimi i librave të bibliotekës së manastirit

Këtu poshtë po shënojmë librat që ndodhen në bibliotekën, duke dhënë numrin vargor, numër që do të jetë edhe në libër, ashtu dhe mesin e librës ku është e shtypur dhe në çë vit.

- 1-Libri i shkrojtur prej Ohnës Orologjtit në gjuhë elenisht e latinisht, shtypur në Veneti, në vitin 1756.
- 2-Libri i Shën Joan Gojartit, Tomos secundis, shrypur në Veneti, në vitin MDCC XXXIV.
- 3-Libri i Shën Joan Gojartit, Tomos primos, shrypur në Veneti, në vitin MDCC XXXIV.
- 4-Libri i Shën Joan Gojartit, Tomos secundis, shrypur në Veneti, në vitin MDCC XXXIV.
- 5-Dialog Historik i Palladhiut episkopit Elinopolis, pa datë.
- 6-Libri i Shën Joan Gojartit, Tomos oktanus, shrypur në Veneti, në vitin MDCC XXXIV.
- 7-Libri i Shën Joan Gojartit, Tomos quindus, shrypur në Veneti, në vitin MDCC XXXIV.

8-Libri i Shën Joan Gojartit, Tomos decimus, shrypur në Veneti, në vitin MDCC XXXIV.

9-Libri i Shën Joan Gojartit, Tomos tertius, shrypur në Veneti, në vitin MDCC XXXIV.

10-Libri i Shën Joan Gojartit, Tomos sectus, shrypur në Veneti, në vitin MDCC XXXIV.

11-Libri i Shën Joan Gojartit, Tomos secundis, shrypur në Veneti, në vitin MDCC XXXIV.

12-Libri i Shën Joan Gojartit, Tomos extant, shrypur në Veneti, në vitin MDCC XXXIV.

13-Libri i Shën Joan Gojartit, Tomos nonus, shrypur në Veneti, në vitin MDCC XXXIV.

14-Libri i Shën Dionis Aeropagitit, Tomus secundis, MDCC XXXIV.

Librat e sipërpërmendur janë gjysmat në elenisht dhe gjysmat në latinisht. Dy të Shën Dionis Aeropagitit, episkopit të Athinës dhe dymbëdhjetë janë të Joan Gojartit, kryepiskopit të Kostandinopojës. Të gjitha përgjysmë, elenishte dhe latinisht.

15-Libër, fjalor tregjuhësh elenisht, Tomi i dytë, shtypur në Athinë, në vitin 1891.

16-Librat e shërbesës së Shën Visarionit, episkopit të Larisë, çudibërësit. Të këtillë libra janë copë njëqind e trembëdhjetë (113), shtypur në Voskopojë në vitin 1744.

17-Libri fjalor, Tomi i parë, si i sipërpërmenduri, shtypur në Athinë, në vitin 1891.

18-Libër, Jeta e Jesu Krishtit, shtypur në Athinë në vitin 1893.

19-Të katër ungjijtë në gjuhën elenisht, data u mungon.

20-Histori kishtare prej Meletios, mitropolitit të Athinës, shtypur në Veneti në vitin 1783.

21-Gjimmastikë shpirtërore prej monak Nikodhimit, shtypur në Veneti në vitin 1800.

22-Libër, i quajtur Katekizma prej zotit Qirill, shtypur në Lipsi në vitin 1758.

23-Libër kishtar prej Dhositheut të Jeruzalemit, data i mungon.

24-Libër Dhiatë e Vjetër, që përmban Të bërët dhe gjithë Dhiatën e Vjetër, data i mungon.

25-Një Ungjill prej Theofilaktit, kryepeshkopit të Vollogarisë, data i mungon.

26-Libri prej Krisanthit, patrikut të Jeruzalemit, që flet për dhenë e shënjtë të Palestinës, shtypur në Hio, në vitin 1726.

27-Libri i Krisanthit, noterit prift dhe arkimandrit, patrik i Jeruzalemit që flet për shkronjë e rrumbullakët e dheut, libër me matëse gjeomentike, shtypur në Paris në vitin 1716.

28-Libri i Simeonit, kryepeshkopit të Thesalonikës, shtypur në Moldavi në vitin 1683.

29-12 copë libra, shtypur në Voskopoje në vitin 1744.

30-Libri Neos Klimakos (shkallët e reja), shtypur në Veneti, në vitin 1693.

31-Një libër i vjetër pa datë.

32-Një libër dogmatike, pa datë.

33-Një libër fjalimesh, pa datë.

Deri në këtë datë vërtetohet se në manastirin e Shën Pjetrit ndodhen sendet e naltshënuara.

Shën Pjetër, më 1 janar 1943.

Igumeni jeromonak At Kozma

Famullitari i katundit Vithkuq

Si kryetar i këshillit kishtar, Atë Gjergji Deti.

Anëtarët.

Faqe 9

Regjistrimi i ndërtesave të manastirit

Këtu poshtë po shënojmë ndërtesat e kohën e dhuruesit, ashtu dhe gjithë dhomat e tjera, duke përshkruar në çë gjendje janë sot dhe përse përdoren dhe duke vënë nga një numër përbri derës së çdo dhome, dhe ay numur që ka dhoma është i shënuar edhe në lëtë libër numër vargor.

1-Kisha e manastirit është në gjendje të mirë, veç nga ana e rrugës që është muri në dhe është prishur zografia.

2-Kur del nga kthesa dhe shkon për nga lindja, janë dhomat e vjetra që rrinin kallogjerët (murgjit) dhe janë regulluar. Tash përdoren përdhe përposh për bodrum me qemer çmërsi.

3-Karshi derës së kishës është një derë me qemer që zbret në haurët që janë ngritur dhomat dhe mbi to edhe mbi kohërat e moçme përdorëshin për kafshët, por sot rrinë bosh se kafshët rrinë poshtë në hauret ngritur thuajse të rinj.

4-Kur del nga kisha dhe vazhdon nga perëndimi në anë të djathtë dhe mu pranë sterës (pusit) nuk është në gjendje të mirë dhe përdoret për të vënë sende.

5-Dhoma pas kësaj dhe kjo nuk është në gjendje aqë të mirë, shumë e vjetër.

6-Dhoma pas kësaj është si e mësipërmja e pandërtuar.

7-Kjo dhomë është sipër me qemer prej çmërsi në vend të tavanit dhe është përdorur për depozitim e bereqetit, meqenëse nuk ka patur hambarë për drithërat. Kjo dhomë është lojtur muri nga ana e veriut dhe është forcuar me anë të murit të fortë që është për t'u shënuar që është bërë në vitin 1924, kur igumen ka qenë i përndershmi Atë Zaharia nga katundi Kulurit dhe si këshillë ka qenë z.z. Nuçi V. Tona e Ilo Kov Deti dhe Ilo Jorgji Prifti.

8-Dhomë e vogël e pandrequr dhe përdoret sot si depo për qereste.

9-Haur që ndodhet pas shkallëve dhe përdoret për dru.

10-Haur që ndodhet nënë shkallët që përdoret për kafshët që rrinë lart dhe sipër është me qemer çmërsi.

11-Dhomë e pandërtuar mirë me qemer sipër prej çmërsi dhe me qenë se nga ana jugore ndodhet në dhe, përdoret për bulmet.

12-Kjo përdoret për kishë për gratë. Tavanin e ka ndërtuar aqë mirë të sipërshtënuarit Jani. Kati i poshtëm rreth oborrit së kishës.

Faqe 10.

Këtu po shënojmë dhomat e katit të dytë.

13-Dhoma në krye të shkallëve është e vjetër me tavan prej dhoge (dërrasë) dhe përdoret si depo për sende ushqimore.

14-Kjo dhomë është pa dysheme, është në truall të vjetër e pandërtuar mirë dhe tavan me gëlqere në kohët e para përdorej si gjelltoe.

15-Kjo dhomë është pas shkallëve më të mëngjër. Nuk është fare e ndrequr mbi tavan gëlqere në dorë të dytë.

16-Pas kësaj gjithë si sipërfaqe jo fare keq.

17-Pas kësaj si sipërfaqe, si e mësipërmja.

18-Pas kësaj si sipërfaqe, si e mësipërmja.

19-Kjo dhomë ndodhet mbi kubënë që është pas derës së kishës dhe në vend të tavanit është me kube (qemer) prej çmërsi dhe përdoret për bibliotekë.

20-Kjo dhomë është në gjendje të mirë, tavan me dërrasa, edhe i thonë dhoma e dhespotit.

21-Si e mësipërmja, tavan me dërrasa e dhoga.

22-Si e mësipërmja, tavan me dërrasa e dhoga.

23-Si e mësipërmja, tavan me dërrasa e dhoga.

24-Kjo dhomë është e pandërtuar me tavan.

25-Kjo dhomë me emër është dhoma e papa Sevos. Jo e keqe, tavan me gëlqere.

26-Dhe pas kësaj dhoma është një tullë e ngushtë që del në ballkon nga ana e Shën Thanasit e nga Borishti.

27-Si e mësipërmja.

28-Si e mësipërmja.

Këtu poshtë po shënojmë dhomat e katit të tretë. Këto dhoma janë ndërtuar prej banorëve vithkuqarë që kanë qenë në mërgim jashtë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 1907, të cilët mblodhën ndihma prej bashkatdhetarëve dhe u dërguan në dorë të zz. Vangjel Tasi e Isak Vasil Rikës, që u ngarkuan me kujdestarinë për ndërtimin e këtyre dhomave dhe u ndërtuan në vitin 1908.

29-Kjo dhomë është në krye të shkallëve dhe është në gjendje të mirë. Tavanin me gëlqere dhe mban emrin dhoma e igumenit.

30-Dhoma mbi portën përdoret si sallon pritjeje dhe mbi të është një dhomë e pandërtuar që është bërë për kambanerinë.

Faqe 11.

Vazhdon kati i tretë.

31-Kjo dhomë është e vogël e ngushtë për fjetje. Është në gjendje të mirë.

32-Pas kësaj dhome e ndërtuar mirë me tavan gëlqereje.

33-Gjithë si e mësipërmja në gjendje të mirë.

34-Gjithë si e mësipërmja në gjendje të mirë.

35-Gjithë si e mësipërmja në gjendje të mirë.

36-Dhomë e ndërtuar mirë dhe përdoret për pritje vizitorësh dhe që mban emrin dhoma e epitropëve (kujdestarëve) për arsye se këtu mblidhet këshilli igumenal.

Shtojmë se në katin e parë ndodhet një hajati i punuar me kollona me gurë dhe me qemerë prej çmërsi që është rreth e përqark oborrit. Në ditën e panairit rrinë çestërshitë. Gjithashtu edhe në katin e dytë mbi këtë hajati është një divan (sallë) që shërben si rrugë për të vajtur për tek dhomat. Edhe në katin e tretë përpara dhomave është një divan (sallë) por ky salloni është i mbyllur me xhamllëk dhe me tavan prej dërrase.

37-Në katin e dytë nga ana jugore, kur del nga dera, është një sallë e madhe mbi atë të epitropëve që përdoret për të mbajtur depozitat e ujit pijës.

38-Më të mëngjër të kësaj sale është ndërtuar ndërtesa e gjeltores, e pandërtuar mirë, ku ndodhet edhe furra për pjekjen e bukës.

Vërtetohet se deri në këtë datë vërtetohet manastiri ka pasur këto dhoma që shënohen këtu.

Shën Pjetër, më 1 janar 1943.

Igumeni jeromonak Atë Kozma

Famullitari i katundit Vithkuq

Si kryetar i këshillit kishtar, Atë Gjergji Deti.

Anëtarët.

Faqe 12

Regjistrimi i sendeve të manastirit

Këtu poshtë po shënojmë sendet që ndodhen sot në manastir, si rroba, qilima, enurina e të tjera.

1-Velenxa të bardha, të reja e të vjetra, gjithsej copë 12.

2-Velenxa të kuqe, katër të mëdha e një e vogël, gjithsej 5 copë.

3-Qilima të rinj e të vjetër, copë gjithsej 10.

4-Qilima këndje të rinj e të vjetër, copë 8.

5-Dyshekë të rinj e të vjetër, copë 2.

- 6-Jastëkë të leshtë 15.
- 7-Jorganë 2, një i madh e një i vogël.
- 8-Krevate 3, njëri pa sustë.
- 9-Karekla 49 dhe 1 kolltuk.
- 10-Trapeza të mëdha 11.
- 11-Trapeza të vogla 10 dhe një prej hekuri.
- 12-Perde penxheresh 17.
- 13-Senduke, një i madh dhe tre të rinj.
- 14-Senduke të vegjël 13.
- 15-Sofra të gjata 8.
- 16-Kupa uji 28, prej rakije 15.
- 17-Një dollap me xham e dy të mesëm.
- 18-Kana prej furfurie 5 dhe një prej çingoje.
- 19-Llampa prej qelqi 23.
- 20-Një pasqyrë dhe një kramastar.
- 21-Pjata prej furfurie 37, çingoje 17.
- 22-Çanakë copë 29.
- 23-Tavë prej bakëri 2 copë, njera me doreza.
- 24-Tavë prej balte 5 copë.
- 25-Tiganë bakëri 3.
- 26-Tepsi bakëri 8, prej çingoje 3.
- 27-Kazanë tre.
- 28-Gjyma 3, dy të mëdhenj dhe një i vogël.
- 29-Lugë prej çingoje të mëdha 26.
- 30-Thika copë 12.
- 31-Filxhanë copë 20, një çajnik.
- Faqe 13.
- 32-Tenxhere bakëri 3, dy të mëdha dhe një e vogël.
- 33-Kungull uji një.

- 34-Dhisqe prej çingoje 6 dhe 2 prej teneqeje.
35-Stoma të mëdha 14.
36-Kade të mëdha e të vogla 13.
37-Turdje, dy të mëdha e të vogla 13.
38-Një satër për mish dhe një fener për mish.
39-Teneqe qumështi 4.
40-Teneqe për ujë 4.
41-Fuçi benzine 1, vozë vere 2.
42-Derموj 2, shosha 3, sita 4.
43-Govatë 1, shinik 1, lopatë furre 1.
44-Një saç, një sofë e vjetër.
45-Kanistra 8, rrogozë 12.
46-Frone të gjatë 9.
47-Hambarë 2, njeri me gjithë magje.
48-Magje e vogël një dhe katër dërrasa buke.
49-Kanape me stromë 1.
50-Fenerë, 2 të mëdhenj dhe një i vogël.
51-Zile të mëdha.
52-Hirku dy sëpatë.
53-Thasë, shtatë prej lino dhe një prej lesi.
54-Një hartë e Europës.
55-Kripore 3, mastrapa 3.
56-Një kornizë që përmban njohjen e autoqefalisë së kishës sonë.
57-Zengji një, pulë me vulën (shtypës).
58-Një petromaks (femer) që përdoret ditën e panairit.
Vërtetohet se në manastirin Shën Pjetër ndodheshin deri në këtë datë sendet e sipërhënuara.
Igumeni jeromonak Atë Kozma
Famullitari i katundit Vithkuq

Si kryetar i Këshillit Kishtar Atë Gjergji Deti.
Anëtarët.

Faqe 27

Regjistrimi i tokave të manastirit

Këtu poshtë po shënojmë tokat e manastirit Shën Pjetër të ndara truall e korije ato që janë aty rrotull dhe ato që ku në katundin Leshnjë.

1-Një korije (pyll) rrotull kishës që mund të jetëme njëzet kille farë dhe që ka dru lisi, mullizi, kreka etj.

2-Një korije (pyll) përtej nga Bodrishta që mund të vijë sipërfaqe prej 18 kille farë dhe përmban dy.....

3-Toka të punuara (ara) në vendin që quhet Nano, një arë prej gjashtë (6) kille farë dhe kufizohet nga lindja me rrugën publike, nga perëndimi është përroi i Nanos, nga veriu një pjesë e luadhit të manastirit dhe nga jugu me vijën e mullirit.

4-Në mes të kësaj are është dhe pjesë që e ndan rrugën e Fambriku Elektrik, dy killa farrë përmbrenda në këta kufi.

5-Një arë tek vendi Varri i Bramkës, në sipërfaqe prej (5) pesë kille farë, kufizohet nga lindja me përroin e Nakos, nga perëndimi prej vijës së ujit, nga veriu ...që ndan arat e tjera, nga jugu me Miti K. Renxa dhe lumi.

6-Një arë në dërrasë prej 1 ^{1/2} farë kufizohet nga lindja Përroi i Thatë, nga perëndimi rruga, nga veriu mali i Drrasës dhe jugu rruga.

7-Një prapa kishës Shën Thanas dhe me rrugën një vete në burim të Borishtit dhe poshtë me arat me luadhe një sipërfaqe prej 14 kille farë dhe kufizohet nga lindja me rrugën që shkon bagëtia e fshatit, nga perëndimi me rrugën e Bodrishtit dhe Shën Thanasin, nga veriu korija (pylli) dhe nga jugu me rrugën që shkon për Leshnjë.

8-Një arë mbi udhë të Bodrishtit me sipërfaqe 2 kille farë dhe kufizohet nga lindja me përroin, nga perëndimi me bregun, nga veriu përroin dhe nga jugu me vijën e ujit.

9-Një pjesë arë në vendin Arat e Igumenit me sipërfaqe prej 10 kille farrë dhe kufizohet nga lindja me rrugën dhe malin, nga jugu....
Faqe 28,

10-Ara në grupi i Thanës, me sipërfaqe 1 ½ kille farë dhe kufizohet nga lindja me malin, nga perëndimi me malin, nga jugu me lumin dhe veriu me malin.

11-Luadhi në Shën Thanas, me sipërfaqe prej 2 kille farë dhe kufizohet nga lindja me rrugën dhe bregun e Shën Thanasit, nga veriu me bregun dhe nga jugu me rrugën publike.

12-Një pjesë luadh në rrugën, 1 një kille farë.

Këtu poshtë po shënojmë tokat që ka manastiri në katundin Leshnjë që mund të jenë ara nga dyqind kille farë dhe luadhe ndonjë pesëdhjetë kille farë, për të cilën toka manastiri ka zotërimin për arsye të ketë tokë e ka blerë nga bej nga Frashëri që ka patur çiflig këtë katund, të cilin Titra ndodhen në vëllazëria K. Turtulli në Korçë, mban ata kanë qenë kujdestarë në tokat më parë, të cilat dokumentet tregojnë mbi saktësinë e sipërfaqes gjithashtu dhe kufizimin e tyre.

Vërtetohet se deri në këtë datë manastiri Shën Pjetër ka pasur tokat e naltpërmendura.

Shën Pjetër, më 1 janar 1943.

Igumeni jeromonak Atë Kozma

Famullitari i katundit Vithkuq

Si kryetar i këshillit kishtar Atë Gjergji Deti.

Anëtarët.

Faqe 66

Regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të manastirit

Këtu poshtë po shënojmë pasurinë e manastirit tonë Shën Pjetër, që ndodhet në Nartë të Vlorës, si ullinj, sa rrënjë në çë sipërfaqe toke, në çë persona kufizohen nga çdo anë.

1-Baçe, që ndodhet në vendin Mizo ndodhen rrënjë ullinj 21, kufizohet nga lindja me Petro Papa, Vasil dhe është Mitro 82. Në veri kufizohet me Shën Tafon (Varrin e Shënjtë) dhe është metra 15. Në jugë kufizohet me Jani Spiro Donin dhe është metra 15.

2-Në vendin Buvillta është një baçe që ndodhet në të 14 rrënjë ullinj dhe kufizohet nga lindja me Petro Zogën dhe Theodhor Zogën dhe është metro 40. Nga perëndimi kufizohet me Nasho Barlarin dhe është metro 40. Nga veriu kufizohet me Shën Joan Prodhromin dhe metro 50. Nga jugu kufizohet me Goli Vidën dhe Shën Naumin e Pogradecit dhe është metro 50.

3-Në vendin që quhet Llako, në vreshtat e Qendro Gervenit ndodhet një rrënjë ulliri.

4-Në vendin ipso në krye të baçes Sloj Andreu ndodhen dy rrënjë ullinj.

5-Në vendin ipso në vreshtit të Vangjel Sevës ndodhen tre rrënjë ullinj.

6-Në baçe të Nako Qirkos ndodhet një rrënjë ulliri.

7-Në vreshtin e Kron Paskos ndodhen tre rrënjë ulliri.

Faqe 67.

8-Në baçe të Nikolla Konomit ndodhet një rrënjë ulliri.

9-Në vreshtë të Andrea Xhaxho ndodhen pesë rrënjë ulliri. Të mbillej edhe një agrilidhe gjithsej 6.

10-Në baçen e Filip Qirkos ndodhen dy rrënjë ullinj.

Shuma e përgjithshme është 55.

Ky regjistrim është bërë prej Atë Gjergj Detit, famullitarit të katundit Vithkuq me rastin që udhëtova nga ana e Vlorës për në Konispol për të bërë atje një fushatë në bagëti për manastirin tonë të shumëdëmtuar nga lufta dhe për të më treguar ullinjtë e sipërpërmendur kam pasur marrë shokun Nasho Zilo nga katundi Nartë e Vlorës, që më rrëfen vendet ku ndohen ullinjtë dhe me cilin person kufizohen përveç dy baçeve private që janë shënuar me nr. 1 e 2 në faqen 66 të këtij libri. Të tjerë për baçen private dhe ... por të gjashtë rrënjët që ndodhen në vreshtin e Andrea Xhaxhos, që në numrin vargor 9 nuk ngjan që vendi të jetë i tija dhe ullinjtë e manastirit, pasi thuajse toka ishte e papunuar nga gjashtë rrënjë ullinj dhe këta që duket se ky person duke mbjellë vreshtën atje në vendin e manastirit thotë se e ka të tijën dhe me qenë se kjo pasuri ka qenë e pakontrolluar prej këshillave të mëparshme të manastirit ngjan të jenë bërë ndryshime në tokat. Neve në këtë rast kaqë mundëm të bëjmë, por që ishte nevoja të kqyret mirë kjo pasuri sipas mendimit tim ku unë kuptova nga ky rast dhe në kqyrjen që mund të bëhet duhet që regjistrimi ta vërtetojë dhe këshilla e katundit Nartë, ku ndodhet pasuria për mos bërë ndryshim me tokën e naltpërmendur.

Ky regjistrim u bë më 9 prill të vitit 1945.

Famullitari i katundit Vithkuq dhe sot

Kryetari i këshillit manastirial

Atë Gjergji Deti

Regjistrimi i kishës së Shën Thanasit

Këtu poshtë po shënojmë mbi kishën e Shën Thanasit. Kjo kishë është ndërtuar në vitin (Ë .ÑÎ .Â). Këto shkronja përmbajnë vitin e ndërtimit të kësaj kishë. Ka edhe shkronja të tjera, por nuk lëçiten dot mirë për arsye se janë të gjuhës helenishte të vjetër dhe një pjesë e tyre është prishur nga mosmirëmbajtja. Këto ndodhen në pjesën e kishës së grave mbi derën që hyn në kishën e burrave. Merret vesh si nga shkronjat që janë më të vjetra se të kishëve të tjera dhe nga gojëdhëna e më pleqve që thonë se në këtë vend rrotull kësaj kishë në Bodrisht e Nanut ka filluar katundi Vithkuq. Në këtë kishë ndodhen sot këto sende të shenjta.

- 1-Në jerore, nuk ka gjë tjetër veçse një temjanicë prej hekuri.
- 2-Në tempull në anë të djathtë, kora e Jesu Krishtit, pa datë.
- 3-Kora e Shën Joan Pagëzorit dhe e kryeengjellit Mihail, pa datë.
- 4-Në anë të mëngjër, kora e Shën Marisë, e Shën Thanasit, e Shën Mitrit, pa datë.
- 5-Kora e Shën Kollit dhe e Shën Profitit Ilia. Këto të dyja janë zografisur mbi suvanë e gëlqeles, d.m.th nuk janë në drasë.
- 6-Në sërën e dytë, 17 kora të vogla, Jesu Krishti në mal dhe Shën Joan Pagëzori e Shën Maria dhe të dy kryeengjëjt dhe të dy mbëdhjetë apostujtë.
- 7-Në sërën e tretë nëntë kora që përmbajnë fytyrat e profitëve dhe kryqi i madh mbi to me Krishtin e Kryqëzuar.
- 8-Nga ana e djathtë, kora e Shën Joan Theollogut.
- 9-Tri kandile, dy makale të hekurt.

Kisha ka edhe zografi nëpër muret por pjesërisht janë prishur nga vjetëria që ka kjo kishë. Kisha ka historinë e fshatit Vithkuq. Pranë kësaj kishë ndodhen edhe konakët e dhe hauret e kafshëve

dhe plevicën e lëmi i manastirit që pothuajse këto janë bërë të gjitha të reja.

Faqe 70

Çregjistrimi i kishës së Shën Thanasit

Këtu poshtë po shënojmë me keqardhje çregjistrimin e kishës së Shën Thanasit, e cila u dogj më datë 28.08.1943 prej ushtrisë italiane që sulmoi katundin tonë.

Kjo kishë historike ka qenë më e vjetra kishë e katundit tonë dhe vetëm deri në këto kohë ka mundur të shpëtojë. Të mos jetë prishur fare vendi ku shkronjat datë e viti i ngritjes së kësaj kishe, për të cilën jami interesuar dhe i kemi bërë njëfarë mbrojtje për të mos u lagur nga shirat, mbasi shkrimi ishte bërë mbi suvanë e gëlqeres që ndodhet mbi derën e kishës së grave në perëndim të kishës së burrave. Por me largimin e ushtarëve çkatërrimtarë të kohës.....Shpresojmë se besnikët kristianë me gjithë shoqërinë shqiptare nuk do ta kursejnë mundimin për ta rindërtuar këtë kishë historike e antike për Shqipërinë e re demokratike.

Vithkuq, më 13.1.1945

Famullitari i katundit Vithkuq

Atë Gjergji Deti

Faqe 192

Vendimi i këshillit manastirial për një fushatë për bagëti

Në lidhje me vendimin e këshillit manastirial nr.5, datë 19-III-1945 që flet mbi një fushatë në bagëti për rimëkëmbjen e manastirit tonë, Shën Pjetër, për këtë punë kjo këshillë ngarkoi të përndershmin famullitarin e katundit tonë Vithkuq, i cili sot kryeson edhe këshillin manastirial dhe janë lutur gjithë dashamirësit që do

të kenë mirësinë për rimëkëmbjen e manastirit tonë që është dëmtuar aqë rëndë nga okupatorët nazisto-fashistë që të shënojë me dorën e tij dhuratën që do të japi secili në këtë libër të inventarit, libër i cili do të ruhet me kujdes prej gjithë këshillave të ardhshëm edhe emrat e dhuronjësve do të shënohen në listat që do të vihen në sallonin e pritjes që do të ketë manastiri.

Vithkuq 20-III-1945

Këshilli Manastirial

Atë Gjergji Deti

Sotir Duni

Ligor Nasi

E Shenjta Episkopatë e Korçës vërteton.

Episkopi Agathangjel

Firma dhe vula